



Sistemi financiar "veresie"

Listat janë mbushur plot dhe "kredia" s'përballohet dot më.



Foto-arkiv: Pazari i Korçës në grevë (qershor 2007)

A e dinë kush është Branisllav Nushiqi

Ky është titulli i një shkrimi, me sa me kujtohet i vitit 1990, botuar tek Gazeta "Fjala" e Kosovës, e përdyjavshme, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Kosovës në atë kohë.

E mbajta me fanatizëm, për gati tre vjet dhe kur u krijua qeveria demokratike, pas zgjedhjeve të marsit 1992 e dërgova për botim tek RD, me anën e përfaqësuesve të zgjedhur të PD në Pogradec se isha i bindur që duhej bërë publik dhe në Shqipëri. Më thanë se do të botohej, por nuk u bë. Pas disa muajsh kur e pashë se nuk po botohej, kërkova të më kthehej, por më thanë se ka humbur rastësisht dhe nuk gjendet. E kam kërkuar më pas me të njohur e miq që lëvrojnë fushën e penës e dijes, për t'u

gjendur në Prishtinë a gjetkë e më është kthyer përgjigje se nuk gjendej.

Shkrimi më ra në dorë kur akoma ishte terr e mezi dukej shkëndijë. Ishim në zbor (përgatitje ushtarake).

Në "Fushën e Madhe" në malet e Çervenakës. Fari Liçollari kishte mbështjellë bukën me gazetën "RILINDJA" të Kosovës. E mora fletën e gazetës dhe e pyeta si i kishte rënë në dorë. Më tha se ia kishin dhënë shoferët kosovarë që vinin për të marrë tulla në Shqipëri. Në atë kohë Fariu ishte me punë kontrollor veteriner në Doganën e Q.Thanës.

Vijon në faqen 13



Banka Popullore, dega Pogradec u bën thirrje të gjithë qytetarëve të Pogradecit të ndihmojnë për mjekimin e të riut Kliti Kërzhalli duke derdhur kontributet e tyre financiare në numrin e llogarisë

104 039

SUPLEMENT



Edhe unë jam PJESEMARRES

Prioritetet e bashkisë për vitin 2009

Lexoni në faqen 7

Pyetje të këshilltarëve dhe përgjigje

Do të parashikohet edhe një kors për biçikletat si në Gjermani. Siç duket turneu ka shërbyer për të marrë përvojë të mirë

Lexoni në faqen 8

PRONONCIME nga këshilltarët



Lexoni në faqen 9

Buxheti: shifra inkurajuese

Lexoni në faqen 10

Buxheti dhe menaxhimi i tij në qeverisjen vendore

Lexoni në faqen 11

Viti 2008 ka patur 63 lindje më pak se 2007

Nga lindjet e vitit 2008 në maternitetin e Korçës të bie në sy numri i madh i meshkujve ndaj femrave. Kjo ka ardhur si rezultat i përzgjedhjes që bëjnë çiftet. Po ta krahasosh vitin 2008 me atë 2007 lindjet kanë pësuar një farë rënie. Kjo sipas mjekëve shpjegohet edhe me planifikimin familjar që bëjnë çiftet e reja dhe çiftet që kanë aftësi riprodhuese.

Për vitin 2008 janë regjistruar gjithsej 1140 lindje, nga ku 780 janë të seksit mashkull. Pra djemtë kanë qenë më të shumtë në numër, kur një vit më parë raporti mes meshkujve dhe femrave të lindura në maternitetin e Korçës ishte gati i barabartë me pak më tepër femra. Nga lindjet janë regjistruar 290 me operim cezarian dhe të tjerat me lindje normale. Numri i lindjeve me operim cezarian ka një rënie në krahasim me 2007, ku u shënuan 347 lindje. Por përsëri kjo lloj lindje zë një përqindje të madhe.

Çiftet preferojnë meshkuj



Viti 2008 ka patur 63 lindje më pak se 2007. Nën at prodhuese kanë patur moshën nga 15 deri në 35 vjeç më të shumtat. Ka patur më pak lindje, por janë regjistruar më tepër aborte. Në 2007 janë kryer 265 aborte, ndërsa për vitin 2008 janë kryer 279. Numri i lindjeve nga viti

në vit po ulet. Spitali Gjinekologjik i Korçës ka kapacitete të mjaftueshme. Për vitin 2008 vetëm 31 % e kapacitetit është shfrytëzuar. Ka një ekip mjekësor të kompletuar ku punojnë 12 mjekë të lartë dhe 114 veta ekip mjekësor i mesëm.

Rritet numri i aksidenteve dhe viktimat

Me 70 aksidente të rënda e mbyllën vitin 2008 shoferët korçarë. Pasojat e këtyre aksidenteve ishin 15 të vdekur dhe 28 të plagosur rëndë dhe një numër më i madh me fraktura më të lehta.

Të krahasuar me 2007, shifrat flasin se kemi një rritje të numrit të aksidenteve dhe viktimave. Në vitin 2007 u regjistruan 50 aksidente me 11 viktima.

Me gjithë masat shtrënguese që ka marrë policia e qarkullimit rrugor si gjoba, bllokim të mjeteve e heqje patentash, përsëri aksidentet nuk janë shmangur. Po të udhëtosh me furgon, ajo që të bie në sy është vënia dhe heqja e rripit të sigurimit. Sa kalon postblloku i kontrollit shoferët e heqin rripin. Por si shkak i aksidenteve rreshtohet edhe shpejtësia e madhe tej normave të lejuara sipas tabelave orientuese. Po të vëresh në qytetin e Korçës, atje ku janë vijat e bardha, atje rritet shpejtësia e makinave, se qyteti nuk ka semafor.

Tjetër shkak radhitet konsumi i alkoolit. Por shoferë të vjetër e me përvojë na thonë se veç këtyre shkaqeve që të shpien në gojën e aksidenteve, janë dhe pagjumësia dhe femrat. Kur je pa gjumë mos udhëto, se një dremitje e lehtë, thonë shoferët me përvojë të shkakton aksident të rëndë. Dhe femrat bëhen shpesh burim aksidentesh tragjike, pasi duke patur ato në krah, mund të shkelësh rregullat e qarkullimit. Sidomos shoferët e rinj duhet që të mësojnë nga çdo aksident që ndodh. Po të zbatosh kodin rrugor dhe të gjitha rregullat e shmang aksidentin.

Por ka dhe shkaqe të tjera si parakalimi i gabuar. Goditjet që të vijnë nga mbrapa apo anash sjellin dëmtime të mjetit dhe të vetë shoferit që e drejton. Por veç mjetit që godet, dëme pëson dhe mjete që goditet.

Përsëri vetëvarje

Vetëfljimet me anë të vetëvarjes janë bërë tashmë një fenomen i zakonshëm në rajonin e Korçës. Me 22 raste u mbyll viti 2008. Këtë akt e kryejnë gati të gjitha moshat. Edhe të mitur 12 vjeç dhe të moshuar 75 vjeç kanë hedhur litarin në qafë për të ekzekutuar vetveten. Litar dhe tela kanë qenë mjetet e përdorura.

Në harkun kohor të tri ditëve janë shënuar tre raste. Një në fshatin Vloçisht, Andrea Kabashi 63 vjeç, një në burgun e sigurisë së lartë në Drenovë, Bashkim Muça dhe një në qytetin e Korçës, ku babai i tri vajzave Albert Xhaholli, në kushte tepër të rënda ekonomike dhe psikologjike pas humbjes së bashkëshortes kohë më parë, është vetëvarur në banesën e tij. Para se të kryente këtë akt ai kishte konsumuar sasira të mëdha alkooli.

Harta e personave që vetëvaren ka një shtrirje si në qytet, ashtu dhe në zonat rurale, sidomos në fshatrat e zonave fushore. Në zonat e thella malore nuk ka patur raste të vetëvarjes së meshkujve. Raste të rralla ka patur nga femrat e moshës së re, ku si shkak ka shërbyer prishja e lidhjeve dashurore.

Nga statistikat rezulton se në qarkun e Korçës janë të diagnostikuar rreth njëmijë persona që vuajnë nga depresioni. Është ky kontingjent i prirur për të kryer akte të vetëvrasjes. Ekziston një qendër e mjekimit ditor për këta pacientë, por që nuk ka kushte për t'u mbajtur të shtruar dhe për të marrë mjekim në spital. Korça furnizon me të sëmurë depresivë Elbasanin. Si qëndrojnë një kohë në Elbasan ata kthehen përsëri, por jo të shëruar. Në disa raste ata janë treguar tepër agresivë ndaj të afërmve të tyre, i kanë sulmuar me thika dhe mjete të forta.

Pavioni i Kardiologjisë pa ngrohje

Mungon ngrohja në pavionin e kardiologjisë në spitalin e Korçës. Pacientët për të përballuar të ftohtit kanë marrë kaloriferët e shtëpisë dhe të miqve për t'u ngrohur, pasi dhe temperaturat e këtyre ditëve kanë qenë mjaft të ulta.

Pacientët shprehen se po përballen me mungesën e ngrohjes dhe e kanë zgjidhur duke marrë edhe ngrohësa nga banesat e tyre. Përveç mungesës së barnave të zemrës, të cilët ende i blejnë jashtë, ata nuk po gjejnë asnjë mjedis të ngrohtë. Vetëm shërbimi i mjekëve pa barna, na thotë një pacient, po bëhet falas deri tani me fillimin e vitit të ri. Një tjetër shprehet se edhe serumet i merr jashtë spitalit në farmaci private. Nuk ka ngrohje në këtë pavion në këto ditë të ftohta dimri.

Në spitalin rajonal të Korçës janë katër kaldaja që duhet të realizonin ngrohjen e tij. Por ato janë të amortizuara dhe kanë që prej 10 vitesh që janë montuar. Herë pas here kanë defekte në pjesët fundore të transmetimit të nxehtësisë dhe nuk arrijnë që të ngrohin të gjitha pavionet. Për eliminim e defekteve po punohet, por arnim është, na thonë pacientët. Spitali i Korçës u rikonstruktua që para dy vitesh dhe u shpenzuan 1 milion euro. Por projekti për ngrohje ka mbetur i përcaktuar.

Një projekt për një kaldajë të vetme dhe moderne është përcjellë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe pritet që të marrë miratimin. Projekti kap vlerën e 78 milion lekëve. Mund të jetë e vetmja zgjidhje për të ngrohur spitalin e Korçës.

Veresie nuk japim!

Listat janë mbushur plot dhe “kredia” s’përballohet dot më. Atë politikë sociale që duhet ta bënte shteti me shtresat më të pambrojtura, e ka marrë përsipër deri tani biznesi i vogël, duke shpërndarë mallra veresie. Por kjo është një barrë jo e vogël për shpatullat e një biznesi me njëqind halle.



Sistemi financiar “veresie”

E kisha harruar kuptimin e parë të fjalës veresie, ndërkohë që në kuptime të tjera si “të marrësh veresie” dmth të marrës falas, “të flasësh veresie” dmth të flasësh kot, në hava, vazhdon të përdoren edhe sot. Por një njoftim i vendosur tek dera e një dyqani në Pogradec këto ditë “Veresie nuk japim” ma nxiti kujtesën. U kujtova që shprehja “veresie s’ka” sipas dëshmitarëve të kohës, apo shkrimeve të ndryshme, është përdorur fillimisht në periudhën e mbretit Zog, në fillimet e shtetit të ri shqiptar, kur të varfrit detyroheshin shpesh të merrnin tek tregtari ushqime veresie ose me listë.

Për herë të fundit e kam hasur tek një nga librat e humoristit të njohur Qamil Buxheli, ku dikush kishte ngatërruar në dyqanin e vet duke bashkuar dy parulla. Parullës komuniste “Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni” i kishte humbur fjala e fundit dhe në vend të saj ai kishte shtuar diçka tjetër që i kish zënë dora. Kështu kishte dalë parulla “Proletarë të të gjitha vendeve, veresie s’ka”. Ka pasur edhe tregtarë zemërmirë që i paralajmëronin blerësit e varfër, duke bërë ndonjë rimë të tipit:

“veresie nuk ka hije”. Sigurisht të gjitha këto të rinjtë nuk i dinë, ndaj pyesin ç’do të thotë “veresie”? Në të vërtetë “veresien” e kemi pasur dhe e kemi fare pranë.

Për siguri iu ktheva fjalorit të madh të gjuhës shqipe. Nuk kisha gabuar: kuptimi i parë i fjalës “veresie” –të blesh një mall pa para në dorë, me kusht që blerësi ta paguajë më vonë. Ai njoftimi në derën e një dyqani në Pogradec “Veresie nuk japim” tani merrte kuptim të plotë. Edhe më tepër sqarohet ai pas një lajmi të kohëve të fundit që në Korçë kanë falimentuar 300 biznese të vogla. Tashmë askush nuk e vë në dyshim faktin e blerjes së ushqimeve me lista; një blerje që ndryshe quhet edhe “blerje me kredi”, por që të vetmin dokument ka një bllok ku shitësi regjistron emrin e debitorit dhe shumën e borxhit.

Blerja veresie ka vite që tek ne është kthyer në sistem, jo vetëm për artikujt më të domosdoshëm ushqimorë, por edhe për mobilje, pajisje elektroshtëpiake, veshje etj. Veresia shpesh përcillet zinxhir, nga një hallkë tek tjetra: qytetari bën veresie një tavolinë tek mobilieri dhe i thotë “më prit dy muaj sa të

mbledh lekët”. Mobiljeri merr veresie nga grosisti lëndë të parë duke i premtuar se do ta paguajë shumë shpejt, sapo të marrë paratë e mobiljeve, që ka bërë veresie. Grosisti merr nga importuesi veresie, duke i thënë se do ta shlyejë sapo ta paguajnë mobiljerët që ka furnizuar. Kjo është një piramidë veresie, ku nuk përjashtohet edhe puna veresie: punëdhënësi premtton të shlyejë punëtorin, sapo të marrë pagesën për produktet që ka shitur veresie. Ky zinxhir i ka lidhur këmbët një pjese të mirë të biznesit dhe s’e lë të ecë. Falimentimi në këto raste nuk është larg: mjafton të mos paguajë dot blerësi i fundit i këtij zinxhiri, që e gjithë piramida të shembet. Kjo bëhet më e evidente në klimën e dyshimeve dhe pritjes së një krize ekonomike. Sa larg nesh mund të duket kriza, aq e afërt është. Njoftimi “Veresie nuk japim” është shenja e panikut dhe njëkohësisht e pikës kritike ku ka arritur tregtari i vogël. Listat janë mbushur plot dhe “kredia” s’përballohet dot më. Atë politikë sociale që duhet ta bënte shteti me shtresat më të pambrojtura, e ka marrë përsipër deri tani biznesi i vogël, duke shpërndarë mallra

veresie. Por kjo është një barrë jo e vogël për shpatullat e një biznesi me njëqind halle.


Lista e njerëzve që s’blenë dot bukën e përditshme është bërë një problem i mprehtë. Është një shtresë e tërë, të cilës i janë drejtuar liderët e forcave kryesore politike në periudha fushatash. I kemi parë këta liderë të trokasin në dyert e dyqaneve ushqimore, të marrin blloqet e shitësve të mbushur me emra dhe t’i tundin para kamerave. Në të vërtetë askush prej tyre s’ka bërë gjë për të shkurtuar këto lista. Ato përdoren vetëm si argument për të sulmuar kundërshtarin.

Në shoqërinë tonë të polarizuar përshtaten në mënyrë të përsosur vargjet e Çajupit: “njerëz të pasur sa s’dinë ç’kanë” dhe nga ana tjetër “njerëz të varfër që s’kanë të hanë”. Këtu politika merr fund. Shifrat për mirëqenie e progres s’kanë kuptim, janë thjesht statistika dhe mesatare që s’shprehin realitetin. Jemi thuajse një shekull prapa. Nuk ka vend më as për dinjitetin e një demokracie 18-vjeçare, në një shoqëri, ku ka njerëz që blenë bukën e fëmijëve me lista. Në këtë vend ku tregtari, në prag të falimentimit, detyrohet me dhimbje të nxjerrë për klientët e tij të varfër njoftimin “Veresie nuk japim”.

Ilir Buzali

Ushtarakët mësyjnë në gjykatë

“Po fitohen gjyqet në të dy shkallët e gjykimit, në gjykatën e faktit dhe në të apelit. Të vendosur për të marrë pensionin e munguar prej vitesh, ushtarakët e liruar e në rezervë nuk tërhiqen”, -thotë Kiço Tele, Kryetar i Shoqatës së Ushtarakëve të Liruar e në Rezervë, për qytetin e Korçës.



Tregu i mbushur me baltë

Shkrija e akullit dhe reshjeve të borës së këtij fillimviti e ka mbushur me baltë tregun industrial të qytetit të Korçës. Eshhtë tepër e vështirë që të hysh në mjediset e këtij tregu këto ditë, pasi nuk të lejon balta dhe lluca. Por tregtarët nuk e kanë ndërprerë shitjen e mallrave të tyre. Gjithë ditën ata dergjen mbi baltën e llucën e krijuar nga shkrija e akullit dhe borës.

Tregu industrial i Korçës apo siç njihet dhe Pazari i Vjetër disa herë ka qenë objekt i disa projekteve të Bashkisë për ta mirëmbajtur atë, por është bërë fare pak punë. Pazari është ngritur rreth 200 vjet më parë. Një pjesë e sheshit të tij u shtrua me gur dhe kanë mbetur të zhveshura disa sheshe që zhyten në baltë tani në dimër dhe në pluhur në verë. Para disa vitesh u fol për një projekt prej 500 mijë dollarë, por që nuk u realizua kurrë.

Kompleksi i dyqaneve të vjetra është dhe në vartësi të monumenteve të kulturës, e cila herë pas here ndërhyr për të rregulluar ndonjë suva të fasadave të mureve. Tregu industrial mbetet i ndotur nga balta e lluca këto ditë dimri të buta për Korçën. Kur ka ngrica çdo gjë duket sikur është më rregull se eliminohet balta. Dhe në verë kur bie shi eliminohet pluhuri.

Për pension të parakohshëm dhe për pension suplementar edhe ushtarakët e Korçës janë mësyjur në gjykatë ku padisin ISSH-në. Deri tani janë fituar 7 gjyqe si në shkallën e parë ashtu edhe në apel. Kjo sasi e gjyqeve të fituara edhe pse e pakët në numër, e krahasuar me rrethet e tjera, ka shtuar shpresat edhe për ushtarakët e tjerë që t'i drejtohen gjykatës për të marrë vendimin e saj pozitiv në favor të tyre. Në apel gjenden 13 dosje, të cilat janë fituar në gjykatën e shkallës së parë, ku pritet sa më shpejt nga dita në ditë që të shqyrtohen. Apeli nuk është bërë nga ushtarakët, por

nga ISSH-ja. Në lidhje me këtë problem, Kiço Tele, kryetar i Shoqatës së Ushtarakëve të Liruar në Rezervë për Korçën na sqaroi më tej: “E nisëm pak me vonesë mësymjen në gjykatë për të fituar atë ç’na i kanë dhënë ligjet, por që nuk i kanë vënë në zbatim. Në qytetin e Korçës janë 402 ushtarakë që nuk janë trajtuar me pension të parakohshëm dhe me pension suplementar 272 ushtarakë. Deri tani janë përgatitur 200 kërkesë-padi që do të futen në gjykatë.

Në fillim ushtarakët e Korçës, priten që ligjet 8521 dhe 9418 të zbatoheshin nga qeveria dhe administrata e saj. Por pritja e kaloi masën dhe iu drejtuam gjykatës”. Tele i ushtarakëve të Korçës vazhdon më tej të na flasë për këmbënguljen dhe ndjekjen hap pas hapi të problemeve të ushtarakëve, jo vetëm të qytetit të Korçës, por të mbarë vendit. Një pjesë e ushtarakëve ndodhen në gjendje të

vështirë ekonomike. “Vetëm gjatë javës së fundit janë futur për gjykim 23 dosje në gjykatën e shkallës së parë. Por nga sa jemi ne në korent dhe në kontakt me armatën e ushtarakëve që nuk kanë përfituar pension të parakohshëm, të gjithë ata që ne kemi evidencuar do të përpilojnë kërkesë-padi dhe me dosje të plotësuar do t'i drejtohen gjykatës për të vendosur për të marrë atë që ua kanë dhënë ligjet, por që nuk kanë gjetur zbatim. Ushtarakët e Korçës janë të vendosur që t'i ndjekin të gjitha shkallët e gjykatave. Theksojmë se nga ana e gjykatës së shkallës së parë deri tani nuk ka patur pengesa. Po kështu edhe ushtarakët që nuk kanë përfituar pension suplementar, nuk do t'iu ndahen dyerve të gjykimit deri sa të përfitojnë suplementin e pensionit që u takon. Një pjesë e mirë e ushtarakëve të karrierës janë katandisur në kamarierë apo dalin e shesin në treg si ambulantë.

Shkolla e Vinçanit feston njëqind vjetorin

Të shumta janë shkollat që po mbushin shekullin nëpër fshatrat e Korçës. Që nga koha e hapjes së Mësonjtores së Parë Shqipe në qytetin e Korçës, ku u mësua shqip dhe u shkrua shqip, nuk mbetën mbrapa edhe fshatrat të përfshirë në këtë aksion për të patur një shkollë ku të shkruhej e të lexohej shqip. Para pak kohësh u festua 100-vjetori i shkollës së Progrit në rrethin e Devollit. Por një shkollë shekullore është edhe ajo e fshatit Vinçan në Korçë.

Mësuesi i parë i shkollës së Vinçanit ka qenë hoxha i fshatit Feim Dervishi. Ai kishte mbaruar shkollën e mesme në Turqi, por që nga viti 1903 ai ngjiti në fshat libra shqip dhe e braktisi zanatin e hoxhës e u deklarua legalisht mësues, ku u mësoi bijve të fshatit gjuhën shqipe. Nuk vazhdoi gjatë dhe në vitin 1926 krahas djemve e ndoqën shkollën edhe vajzat e fshatit Vinçan.

Po libra shqip kishte ngjitur në fshat edhe Xhafer Prenjasi, të cilit ia gjeti kosharja turke në dyshekun ku flinte. Ndërsa në vitin 1940 u hap edhe klasa e pestë dhe u quajt shkolla unike. Në vitet e luftës u mbyll dhe u rihap në shtator të vitit 1944. Në Vinçan fill pas çlirimit u çel edhe kopështi për fëmijët. Nga vitet 70' filloi të funksiononte edhe shkolla bujqësore pa shkëputje nga puna. E ndoqën atë shkollë nga

Goskova, Porodina, Damjaneci. U diplomuan me dhjetra agranomë të mesëm.

Në shkollën e Vinçanit kanë dhënë mësim mësuesit Feim Dervishi, Ali Kurtani, Sefer Zaimasi, Dhori Fallo, Dhimitrinë Vreto, Smosogde Fundo, Petrika Dako e shumë të tjerë, si edhe ish nxënës të kësaj shkolle, Sefer Kutani, Ali Bregu etj.

Vetëm nga fshati Vinçan kanë dalë 65 kuadro të lartë, të cilët e kanë nisur mësimin në bankat e shkollës shekullore. Kanë dalë oficerë, mjekë, agronomë e veterinerë të zotë.

Veçojmë ndër ta oficerët Nasip e Sami Vinçani, Tomor Asobella, Demir Fidani, Eqerem Hoxha, mësuesit Ali Bregu, Sefer Kutani, Artesa Bregu, inxhinierët Yllson Asobella, Mehmet Kutoni, mjeku Gjergji Gjata, veterineri Pëllumb Hoxha. Vetëm nga fshati Vinçan ishin këta kuadro që përmendëm, por janë 65 që kanë mbaruar të lartën. Por nuk do të lëmë pa përmendur edhe të tjerë, të cilët mësuan në shkollën e Vinçanit nga fshatrat përreth dhe mbaruan arsimin e lartë. Nga Porodina do të përmendim Gani Çuçllarin, mësues gjuhe, nga Damjaneci mjekun Medi Agolli, mjek në Tiranë.

Në vitet e trazirave aty nuk u prek asnjë dërrasë e shkollës. E

ruajtën vetë fshatarët dhe e kanë sot shkollën model në rreth.

Në kujtim të 100-vjetorit morën pjesë ish nxënës dhe mësues, bashkëfshatarë, të larguar në Tiranë, por që u ftuan dhe u bashkuan për të përjetuar çaste të këndshme nga festimi i 100-vjetorit. Përhëndeti drejtori aktual Drini Rexhepi, i cili mbajti kumtesën: “Strumbullari i shkollës së Vinçanit”.

Përhëndeti Tomorr Asobella për “Kuatrot e larta që dolën nga shkolla e Vinçanit”, dhe “Mësuesit e Vinçanit që kanë dhënë mësim” nga Ali Bregu. Në emër të mësuesve veteranë përhëndeti Maqedon Karanxha. Nga Drejtoria arsimore përhëndeti drejtori Andrea Mano. Me këtë rast nxënësit dhe mësuesit e shkollës dhanë një koncert me këngë e valle të përgatitur nga mësuesi i kësaj shkolle Bujon Bregu.

Organizimi i festimit të 100-vjetorit të shkollës së Vinçanit u bë nga Tomorr Asobella dhe Ali Bregu, të cilët hartuan programin e festimit, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, pushtetin lokal dhe pleqësinë e fshatit. Festimi i 100-vjetorit të shkollës i bashkoi të gjithë njerëzit e Vinçanit dhe i uli pranë njëri-tjetrit, ku ndoqën veprimtaritë me këtë rast, të munguara prej kohësh.

Pëllumb Çuni



Edhe unë jam PJESEMARRRES



Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

Mblidhet Këshilli Bashkiak i Pogradecit Monitoruesit raportojnë

Miratohet buxheti i vitit 2009



Në mbledhjen e radhës Këshilli i Bashkisë së Pogradecit operoi me këtë rend dite:

- Projekt-vendim "Mbi miratimin e bursave për studentët"
- Projekt-vendim "Për ndihmën ekonomike për muajin tetor"
- Projekt-vendim "Për ndihmën ekonomike për muajin nëntor"
- Projekt-vendim "Mbi miratimin e kërkesës së personave që do të vazhdojnë procedurën e privatizimit të banesave shtetërore që kanë mbetur pa privatizuar"
- Projekt-vendim "Mbi miratimin e rregullores për shkarkimet në kanalizimet e ujrave të ndotura në

zonën e shërbimit të UK Pogradec sh.a"

- Projekt-vendim "Për miratimin e tarifës së vrasjes së qenve"
- Projekt-vendim "Mbi strukturën e bashkisë dhe institucioneve dhe ndërmarrjeve në vartësi"
- Projekt-vendim "Për miratimin e prioriteteve për investime për vitin 2009"
- Projekt-vendim "Mbi nivelin e taksave dhe tarifave vendore"
- Projekt-vendim "Mbi miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2009"



Mbyllje viti pa borxhe

Një mbyllje viti pa borxhe dhe fillim i një viti të ri me arritje, ishte ky një nga vlerësimet që u bënë gjatë mbledhjes së fundit të këshillit të Bashkisë i mbledhur në datën 17 dhjetor, për punën e bashkisë, e fundit për vitin 2008. Padyshim që pika më e nxehtë e debatit të mbledhjes së radhës ishte miratimi i buxhetit të vitit 2009. Kështu bashkia e nis vitin e ri me buxhet të miratuar dhe nuk punon si kohë më parë që buxheti miratohej kur kishte nisur viti kalendarik. Bursat e studentëve u miratuan mes një debati të qetë për të kënaqur të gjithë ata persona që plotësojnë kriteret për të përfituar sipas kuotave të të ardhurave. Prioritet iu dha marrjes së bursës jetimëve. Po kështu dhe trajtimi nga ana e bashkisë i katër studentëve me dhjeta. Për këtë u vendos që këtyre studentëve t'iu jepet dhe një fletëmirënjohje nga ana e Këshillit të Bashkisë. Këtë sugjerim e bëri Syrja Palla, i cili u miratua me votim.

vijon në faqen 6

U paraqitën 38 kërkesa për bursa të larta.

Nga këto 21 kërkesa plotësojnë kriterin e trajtimit me bursë ekonomike të plotë, ndërsa 3 plotësojnë kriterin e trajtimit me gjysëm bursë, kurse të tjerët nuk e plotësojnë kriterin e trajtimit me bursë, sepse të ardhurat për person në familjet e tyre janë mbi normën e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1211, datë 27.08.2008.

Zyra Arsimore Pogradec me shkresën nr.329/1, datë 21.11.2008 i ka akorduar Bashkisë së Pogradecit 9 bursa për shkollë të lartë.

Studentë me probleme sociale që përfituan bursë ishin jetimët të parët e më pas të tjerët.

Studentët jetimë që plotësonin kriterin e trajtimit me bursë:

- 1-Eriona Sherolli
- 2-Aldi Blacëri
- 3-Elona Muço
- 4-Enea Guxholli

Studentë me dhjeta:

- 1-Jolanda Vako
- 2-Lazaron Gusho
- 3-Eneda Haxhillari

Me votim pa asnjë ndryshim apo debat u kalua ndihma ekonomike për dy muajt, tetor dhe nëntor. Për



STRUKTURA E BASHKISË

Struktura e Bashkisë për vitin 2009 nuk ka ndryshim në strukturë, në pozicionin e punës asnjë ndryshim nga ajo e vitit 2008. Nuk ka dhe as në numrin e punonjësve.

Aparati i Bashkisë	87 punonjës	Qendra Kulturore	24
Ndërmarrja e taksa-tregjeve	16	Klubi shumësportësh	8
Ndërmarrja e punëve publike	34	Çerdhja	6
Ndërmarrja e gjelbërim-ndriçimit	83	Kinemaja	6

Këshilli miratoi tarifën e re të shpërblimit të gjahtarëve

Rritet tarifa e vrasjes së qenve

Vrasja e qenve nuk kaloi pa u ndjerë në mbledhje. Pati debate dhe mendime rreth masave të ngutshme që duhet të merren për të disiplinuar këtë kategori kafshësh pa pronar që bujt në qytet. Problem për banorët përbën prania e qenve të rrugës që janë shtuar dhe në qytetin e Pogradecit. Përveç rrezikut të përhapjes së sëmundjeve, ata shpesh kanë vënë edhe në rrezik jetën e banorëve duke i sulmuar, sidomos fëmijët. Për në rrugën e spitalit nata është e vështirë se një numër i madh qensh banojnë rreth asaj zone dhe sulen me të lehura.

Kreu i bashkisë kërkoi që me çdo kusht të vriten dhe të zhduken qentë. Më parë tarifa për çdo qen

të vrasë që merrte gjahtari ishte 200 lekë të vjetra. U kërkua që kjo tarifë të rritet dhe u paraqitën dy versione. Një tarifë me 400 lekë dhe një tjetër me 500 lekë, por me votim fitoi tarifa e shpërblimit për çdo qen të vrasë 400 lekë. “Edhe sikur të harxhojmë dy milion lekë të vjetra për vrasjen e qenve, nuk është ndonjë shifër e konsiderueshme për bashkinë, theksoi Artan Shkëmbi, mjafton që të eliminojmë qentë.”

Por këshilltari Lefter Tanellari, ngriti zërin tek “Të drejtat e kafshëve”, kështu që vrasja të mos kryhet, por të gjenden metoda të tjera për të zvogëluar numrin e tyre. Madje Tanellari paraqiti një material ku ishin të detajuara liritë që kafshët

kanë nevojë dhe janë të domosdoshme t’u sigurohen, të cilat janë:

-Liri nga etja, uria dhe keqtrajtimi

-Liri nga shqetësimi, sigurimi i mjedisit dhe zonës së pushimit të rehatshëm.

-Liri nga dhimbja, nga dëmtimet dhe nga sëmundja duke parandaluar dhe duke vendosur diagnozë të shpejtë dhe kryer në kohë mjekimi.

-Liri për të shprehur sjellje normale, duke siguruar një hapësirë të mjaftueshme.

-Liri nga streset, frika dhe vuajtjet.

Kjo sipas OIE-Internacional Health Standarts.

Por këshilltari Lefter Tanellari nuk u përkrah nga këshilltarët e

tjerë, të cilët votuan tarifën e re që u vendos për shpërblimin që duhet të marrin gjahtarët për çdo vrasje qeni në qytet. Nga këshilltari Namik Blacëri, që është edhe anëtar i shoqatës së gjuetarëve, u ngrit si shqetësim koha e ekzekutimit me vrasje e qenve, pasi ka patur raste që edhe janë bërë dëme nga zbrazja e çifteve dhe janë thyer xhama makinash. Vrasja e tyre të bëhet pas orës 02.00 të natës, kur ndërpritet edhe qarkullimi i këmbësorëve dhe makinat nuk janë në lëvizje.

Këshilli e miratoi tarifën e re të shpërblimit të gjahtarëve që do të merren me zhdukjen dhe shfarosjen e qenve të qytetit.



Prioritetet e bashkisë për vitin 2009

Prioritetet për investime, ku do të mbështetet dhe puna e bashkisë kaluan në një sitë të lehtë pasi u miratuan ato që ishin paraqitur në projekt-vendim nga ekspertët përkatës.

“Nuk duhet që të ulim numrin e prioriteve, por a mund të shtojmë sa më tepër, theksoi kreu i Bashkisë Artan Shkëmbi, kur këshilli zbriti për të diskutuar pikën e rendit të ditës për miratimin e prioritetëve për investime për 2009. Kryetari i Bashkisë propozoi të shtohen edhe dy prioritete të tjera:

- Fasadat e qytetit
- Rikonstruksion i godinës së Bashkisë (fasada dhe kati i katërt)

Për prioritetin numër dy, “Rikonstruksion i trotuarit Rr. Rinia dhe Rr. Kajo Karafili (seg. tek Rr. Rinia-Shëtitorja Fan Noli), këshilltarët pyetën se çfarë do të shtohet pasi ky prioritet ka qenë edhe vitin e kaluar.

Përgjigja ishte se do të asfaltohet pjesa e rrugës para KESH.



Për prioritetin nr.13, planin rregullues, Lefter Tanellari propozoi të hiqet pasi ka tre vjet që përsëritet dhe nuk realizohet sepse nuk mund të realizohet. Ky propozim nuk u pranua, shprehimisht u tha që prioritetet mirë është të jenë më shumë, më pak të mos jenë. Ndërsa Gjergji Ilo kërkoi që si prioritet të shtohet edhe hapja e muzeut të qytetit dhe të jemi në këshilltarët që të vizitojmë të parët muzen, sqaroi për kërkesën shtesë që bëri kreu i këshillit bashkiak. Syrja Palla tha se këto nuk janë prioritete, por detyra që duhet të realizohen sepse atje aktualisht po punohet.

Për vitin 2009 bashkia e Pogradecit ka përzgjedhur 13 prioritete, ku do të mbështetet dhe puna e saj për të bërë investime.

Lefter Tanellari kërkoi që të hiqet nga prioritetet Përroi i Çaprazit, por kreu i bashkisë Shkëmbi nguli këmbë që të shtohen dhe prioritetet të tjera për të përfituar sa më shumë për komunitetin me projektet që do t'i paraqiten qeverisë dhe i janë paraqitur për miratim fondesh.

Prioritetet për vitin 2009 janë:

- Rikonstruksioni i bulevardit “10 Dëshmorët e Pojskës”
- Rikonstruksioni i trotuarit rr.“Rinia” dhe rr. “Kajo Karafili”
- Rikonstruksion, sistemim i lumit të qytetit
- Sistemi i ndriçimit rrugor në qytet
- Rikonstruksioni i stadiumit dhe rrugëve lidhëse, lagja nr.1
- Rikonstruksioni i ambienteve tek monumentet në qendër të qytetit dhe shëtitorja në breg të liqenit.
- Realizimi i veprave të artit në parkun e qytetit dhe shëtitorën “Fan Noli”
- Blerje autobusi për sportin
- Ndërtimi i molit në qendër të qytetit.
- Rikonstruksioni i rrugës “Islam Dani”, tek spitali
- Rikonstruksioni dhe sistemimi i bllokut të lagjes 5, trekëndësh rruga e Spitalit -rruga Unazë -rruga “Kajo Karafili”
- Asfaltimi, sistemime lagja Përroi i Çaprazit
- Hartimi i planit rregullues.

Miratimi i taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2009 në përgjithësi janë të njëjtat nivele taksash. Ka vetëm disa ndryshime në tarifa, të cilat janë:

Tarifa e pastrimit ka pësuar një rritje vetëm për kategorinë e biznesit. Kjo rritje del e domosdoshme të bëhet, pasi duhet të mbulohet kostoja e shërbimit të pastrimit, e cila për 2009 është miratuar e rritur.

Për 2009 do të aplikohet tarifa për çdo lejë ndërtimi, pasi ndotësit kryesorë të qytetit janë ndërtimet e reja. Vjelja e kësaj tarife do të kryhet në momentin e zbardhjes së lejës së ndërtimit.

Tarifa e gjelbërimit është tarifë e re, e cila do të fillojë të vilet për herë të parë.

Tarifa e gjelbërimit do të jetë sa gjysma e tarifës së pastrimit. Për çdo familje do të paguhet 500 lekë shtesë në vit.

Tarifë tjetër që shtohet është edhe ajo për shërbimin e varrezave publike,

e cila do të jetë 150 lekë për familje në vit.

Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore si e re për vitin 2009 futet nga bashkia taksë e gjelbërimit.

“Jemi bashkia e fundit që e futim këtë taksë”, -theksoi Shkëmbi prandaj këtë vit të testojmë dhe për vitin që 2010 të kemi fituar përvojë, si kemi bërë edhe për taksat e tjera. Taksë e gjelbërimit është për familjarët, ndërsa biznesi rëndohet me taksën e pastrimit. “Por nuk janë të larta as për biznesin se kur vjen paguan në bashki njëqind mijë lekë të vjetra në muaj dhe në tatime 20-fish nuk iu duket asgjë. Bashkia ka tarifa të ulëta në taksë.

Vangjo Gusho u shpreh se për biznese të barabarta duhet të ketë taksë të njëjta. Të bëhen diferencime. Gjergji Ilo debatoi për taksën që paguan biznesi me tvsh, ku si ai marangozi që ka 5 punëtorë dhe ka një dhomë sa salla e mbledhjeve dhe

“

Për 2009 do të aplikohet tarifa për çdo lejë ndërtimi, pasi ndotësit kryesorë të qytetit janë ndërtimet e reja. Vjelja e kësaj tarife do të kryhet në momentin e zbardhjes së lejës së ndërtimit.

”

ai që ka 50 punëtorë paguajnë njësoj. Po kështu dhe tarifa e ujit të pijshëm u la 57 lekë për metër kub nga bashkia, por që kjo shifër korrektohet nga enti rregullues dhe do të bëhet në mënyrë graduale rritja. Taksë e pastrimit për bizneset rritet 100%, nga 600 mijë lekë shkon në 1,2 milion të vjetra.

Artan Shkëmbi u shpreh se bizneset ndotin mjedisin, nuk mund të ngarkojmë qytetarin. Bile taksë e pastrimit është për familje, por e mira të ishte si tarifë për person. Biznesi jep mbetje urbane të mëdha. Nuk të lodh bashkia me taksat që të merr, të lodhin tatimet, u shpreh Shkëmbi. Për tarifën e gjelbërimit pati debate se a është vendosur mbi kritere të sakta. Por nga kreu i bashkisë u sqaruan se ky vit është vit testimi për opinionin. Ne edhe për taksën e ndriçimit kështu e nisëm. Por edhe ndriçimi ka nevojë për korigjime, ta bëjmë për banorë se paguhet një tarifë fikse. “Pra ka nevojë për korrektime e përmirësime” -u shpreh Artan Shkëmbi.

Këshilltarja Eli Janku tha se ajo nuk ishte njohur me materialet e rregullores për shkarkimet në kanalizimet e ujrave të ndotura në zonën e shërbimit të U.K Pogradec sh.a. se nuk ka rregullore.

Pyetje të këshilltarëve dhe përgjigje

Do të parashikohet edhe një korsi për biçikletat si në Gjermani. Siç duket turneu ka shërbyer për të marrë përvojë të mirë

1-A mundet që studentëve me dhjeta t'u japim një fletëmirënjohje nga ana e këshillit të bashkisë?

-Këtë ta vendosim së bashku e nuk është gjë e keqe që të kenë një dokument të tillë, ku pasqyron dhe punën e këshillit.

2-Për jetimet të shikohet trajtim më i plotë me bursë.

-Për jetimet që plotësojnë kushtet, patjetër që do të trajtohen me përparësi. Një pjesë që kanë të ardhura ekonomike do të marrin më pak bursë, por edhe këta nuk do të lihen pa u trajtuar.

3-Për tarifën e ujit të pishëm nuk kemi asnjë material.

-Materialet kanë qenë në dispozicion, por ju keni munguar herën e parë.

4-A janë të larta tarifat e miratuara më parë?

-Nuk janë të larta për popullatën, pasi ato i ka mbajtur të ulëta enti rregullator dhe sipas kontratës së bërë, ai do t'i ngrejë e t'i shpjegjë atje ku i kemi vendosur në mënyrë graduale.

5-Sa i bie të paguajë populli me tarifat e reja?

-Populli do të paguajë një 50 lekësh më tepër.

6-Pse nuk marrim në analizë ndërmarrjen e ujësjellësit?

-Në mbledhjen e muajit që vjen do të marrim në analizë ndërmarrjen e ujësjellësit.

7-Pse të përdorim vrasjen për qentë?

-Nuk kemi metoda të tjera që t'i vëmë në dispozicion, përveçse zhdukjes së tyre me anë të vrasjes me armë gjahu.

8-Pse të mos shtojmë prioritete të tjera?

-Sa më shumë proritete të kemi, aq më mirë është.

9-Për unazën a ka projekt?

-Ka projekt dhe së shpejti do të nisë

zbatimi i tij.

10-Kur do ta hapim muzeun e qytetit?

-Mbase nga muaji tetor, por edhe më parë do të këmbëngulim.

11-Çfarë do të bëhet për ndriçimin e lulishteve?

-Nga viti në vit do të shtojmë ndriçuesit. Në zbatimin e projekteve prioritet do të jetë dhe ndriçimi. Mos ndërhyjmë më mbrapa për të vënë ndriçues.

12-Taksa e pastrimit për bizneset pse është rritur duke parë se bizneset janë në gjendje të vështirë?

-Ndotjen më të madhe e shkaktojnë bizneset dhe jo familjarët. Por nuk i vret kjo sasi që paguajnë, pasi nuk ka ankesa dhe kundërshtime. Nuk i pengojnë taksat e bashkisë bizneset.

13-Pse ka diferencime në taksën e gjelbërimit?

-Një vit do të jetë edhe apriori taksa e gjelbërimit. Sa ta futim në linjë. Po testojmë opinionin dhe më pas do të bëhen korrektime e nevojshme. Si vepruam me tarifën e ndriçimit për familje. Ndriçimin po e mbledhim për familje deri tani, por mund ta mbledhim edhe për banorë.

14-A janë përfshirë transfertat në buxhetin e ri?

-Nuk do të ketë mbartje shpenzimesh. Buxheti harxhohet brenda vitit. Nuk janë përfshirë transfertat.

15-Pse nuk kemi një korsi për biçikletat?

-Do të parashikohet edhe një korsi për biçikletat si në Gjermani. Siç duket turneu ka shërbyer për të marrë përvojë të mirë.

16-Sa do të jetë realizimi i të ardhurave për 2008?

-Kur të mbyllet viti do të mësoni se sa do të jenë të ardhurat. Ndryshe nga vitet e kaluara, buxheti po miratohet pa e mbyllur vitin, që ta nisim të riun me buxhet të miratuar.



-Qendra rinore e ka humbur rininë e saj. Me hapjen e kurseve private për anglisht dhe për instrumenta nuk ia vlen që të paguash instruktorët kot pa bërë asnjë punë

17-A jemi në gjendje që të garantojmë shpenzimet e 2009-ës?

-Me përvojën e këtyre viteve ne do të garantojmë të gjitha investimet për vitin 2009.

18-A është sqaruar biznesi e popullsia për rritjen e tarifave?

-Sqarime janë bërë, por edhe do të mësohen.

19-Sa biznese kanë paguar e sa jo?

-Nuk ka një shifër të saktë pasi deri në fund të vitit do të rritet numri i bizneseve që paguajnë taksat.

20-Si do të veprohet me çezmat publike?

-Do të shikohet ky problem, pasi harxhojnë një sasi të madhe uji që shkon deri në 120 milion lekë. Nuk mund t'i thajmë menjëherë.

21-Pse nuk parashikohen shpenzime për notin, qitjen, shahun?

-Në këto sporte nuk kemi talente dhe ekipe.

22-Sa është normativa e harxhimit të karburanteve?

-Nuk ka tejkalime në harxhim.

23-Për mirëmbajtjen e shkollave është parashikuar pak në buxhetin e ri.

-Shpenzimet për mirëmbajtje do të

vijnë në ulje pasi shkollat po meremetohen dhe nuk lind më nevoja që të harxhojmë për mirëmbajtjen e tyre.

24-Sa është parashikuar rritja e të ardhurave nga regjistrimi i biznesit?

-Rritja është planifikuar, por këto i gjeni nëpër sektorët përkatës të bashkisë.

25-Qendra rinore a ka mundësi që të bëhet sa më efçente?

-Qendra rinore e ka humbur rininë e saj. Me hapjen e kurseve private për anglisht dhe për instrumenta nuk ia vlen që të paguash instruktorët kot pa bërë asnjë punë.

26-Sa borxhe ka bashkia e të mos mbetet më borxh, por të lahen njëherë e mirë.

-Bashkia nuk ka asnjë borxh për të larë. Për punë të pa kryer nuk kemi paguar askënd. Sa punë ka bërë, aq para ka marrë. E nisim vitin e ri pa borxhe.

27-Për njerëzit e nderuar të qytetit nuk mund të japim ndonjë ndihmë të veçantë?

-Nuk lejohet që të shpërblehen persona madhorë, të talentuar qofshin. Ata janë taksapagues dhe të marrin shpërblim, këtë nuk e lejojnë ligjet aktuale.



PRONONCIME nga këshilltarët

Todi Angjellari

Komisioni i ekonomisë ka ndjekur kurdoherë dhe në kohën e duhur realizimin e të ardhurave dhe ka dhënë mendime të drejta. Nga puna e komisionit të ekonomisë janë edhe arritjet në bashki, pasi ne kemi kërkuar me këmbëngulje që të ndiqen me përparësi problemet në këtë sektor.

Për efekte rutine ka patur raste që nuk jemi mbledhur në çdo muaj, por në muajin pasardhës problemet janë rrahur dhe trajtuar.

Avni Myrto

Këshilli i bashkisë për vitin 2008 ka qenë në korent të problemeve. Ka ndihmuar qytetarët që kanë patur nevojë dhe kanë kërkuar ndihmën tonë. Duhet të ketë më transparencë me komunitetin. Lajmërohet në televizor dhe vihen afishe në hyrje të bashkisë dhe në hyrje të godinës ku bëhen mbledhjet.

OBJEKTIVA

Buxheti i vitit 2009 synon të arrijë këto objektiva:

- përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve
- Më shumë investime
- Mirëmbajtje, sistemim dhe përmirësim të infrastrukturës ekzistuese
- Zhvillim të turizmit dhe sidomos të turizmit kulturor gjatë gjithë vitit
- Zhvillim të traditës, kulturës dhe sporteve
- Nxitje të mëtejshme për biznesin dhe krijimin e hapësirave për biznese të reja.

PRONONCIME nga qytetarët

A.Lame

Nuk kam marrë pjesë asnjëherë në një mbledhje këshilli të bashkisë. Nuk e di se ku bëhen mbledhjet. Me rendin e ditës nuk jam njohur edhe pse më kanë thënë se e jep edhe televizori si njoftim, por nuk më interesojnë. Nuk kam patur hall, që të më shpjerë tek këshilltarët e qytetit tonë.

E.Manellari

Sot po e marr vesh se do të mblidhet këshilli. Unë para këtij sheshi dal shpesh në xhiro dhe takoj miqtë e mi. Po rrallë dëgjojmë që mblidhet. Një herë në dy muaj a në tre ndonjëherë. Nuk më ka interesuar asnjë mbledhje. Nuk e di si i zhvillojnë. Nuk dimë se çfarë thonë. Ndonjëherë më qëllon që të dëgjoj në televizor apo flasim me shokët.



Të ardhurat e krahasuara në vite

Duke parë dhe krahasur këto shifra duket qartë se buxheti i vitit 2009 është tepër inkurajues, ku të ardhurat të krahasuara me vitin 2002 janë parashikuar katër herë më të larta. Edhe po të shohim mbylljen e vitit 2008 të ardhurat janë në nivel të mirë dhe mbi bazën e mbylljes së vitit 2008 janë parashikuar edhe të ardhurat për

vitin 2009. Por këtë vit janë parashikuar më të larta. Gati dy herë më të larta do të jenë të ardhurat për vitin 2009 të krahasuara dhe me një vit më parë si 2008 që u mbyll. Kjo do të thotë se ende ka rezerva ku bashkia mund të thithë të ardhura në buxhetin e saj dhe nga vjelja mirë e taksave do të investojë për t'i dhënë një pamje tjetër qytetit.

viti 2002: 100.635.307 lekë
2003: 127.131.694 lekë
2004: 153347516 lekë
2005: 160.625.997 lekë
2006: 182.739.000 lekë
2007: 212.287.000 lekë
2008: 235.000.000 lekë
2009: 408.077.627 lekë



Buxheti: shifra inkurajuese

shpenzimet do të harxhohen brenda vitit. Pastaj u kalua në pyetje dhe diskutime rreth materialit të paraqitur. I krahasuar me buxhetin e vitit 2008, për 2009 ka rritje të ardhurash dhe shpenzimesh. Në vitin 2008 të ardhurat ishin parashikuar në 235.000.000 lekë, ndërsa për 2009 janë parashikuar në 408.077.627 lekë. Ky buxhet me këto shifra inkurajuese flet për vazhdimësinë e punëve të bashkisë dhe synon në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Më shumë investime, mirëmbajtje e infrastrukturës ekzistuese, zhvillim të turizmit dhe sidomos turizmit kulturor gjatë gjithë vitit, zhvillim të traditës, kulturës dhe sporteve dhe nxitje për biznesin. Këshilltarët dhe pse ishte lënë si pika e fundit e rendit të ditës, kishin energji për të qëndruar më gjatë e për të sqaruar çështje të ndryshme që lidhen me buxhetin si "zemra" e një institucioni siç është edhe bashkia.

Lefter Tanellari kërkoi që në buxhet të shtohen dhe investime për të bërë korsi biçikletash. Hasan Laho rrahu mendime rreth zërave të buxhetit dhe pyeti se duam të dimë sa borxhe kemi dhe na mbeten për vitin 2009 e

t'i shlyejme njëherë e mirë e të mos mbetemi më borxh. Ka reaguar kryetari i Bashkisë Shkëmbi duke u shprehur se "Fjalën borxh mos e përdorni më. Bashkia nuk ka borxhe. Për atë që punë sa kanë bërë janë paguar. Kur të mbarojnë së dorëzuarit objektet atëherë do të marrin dhe lekët."

Sofika Binishi kërkoi të dinte për mirëmbajtjen e shkollave, pse nuk ka shtesë fondesh. U përfshi në diskutim edhe Vangjo Gusho, Avni Myrto, Syrja Palla. Pas pyetjeve dhe sqarimeve që u dhanë nga kryetari i bashkisë dhe diskutimeve, buxheti u miratua dhe u vlerësua edhe nga këshilltarët që nuk e morën fjalën, por e votuan. Gjatë miratimit ai mori të gjitha votat e këshilltarëve pa asnjë kundër apo abstenim.

Buxheti i vitit 2009, i cili u miratua para vitit ushtrimor tregon se këshilli i bashkisë dhe vetë bashkia janë të interesuar dhe të preokupuar që të punojnë me një buxhet të miratuar para dhe të mirëbërë nga ku ai gjeti miratimin e të gjithë këshilltarëve në votim pa asnjë kundër. Ai u mbështet si një buxhet inkurajues që tregon për vazhdimësinë e punës së mirë të bërë nga ana e bashkisë së Pogradecit.

Vëzhgim dhe sugjerim

Gjatë monitorimit vazhdon të vihet re se një pjesë e mirë e këshilltarëve kanë nevojë për trajnime lidhur me komunikimin dhe me mënyrën si duhet të ngrenë problemet. Disa janë pothuajse të heshtur, thuaj se janë atje vetëm për të dëgjuar, duke harruar se për ta është votuar dhe kjo duhet justifikuar.

Vazhdojnë të pinë duhan gjatë mbledhjes, jo vetëm këshilltarët por edhe pjesa e administratës që vjen aty për të dhënë shpjegime, duke krijuar kështu një ambient mbytës e aspak komod.

Karriget për gazetarë, monitorues apo të tjerë pjesëmarrës nga komuniteti janë shumë pak.

Do të rekomandonim që të hartohet një pyetësor i thjeshtë për t'u plotësuar nga këshilltarët si për t'ju kujtuar apo mësuar se për çfarë janë atje. Pyetjet mund të jenë:

-Sa takime keni realizuar me komunitetin?

-Cilat kanë qenë disa nga çështjet që keni diskutuar?

-Cili është prioriteti juaj si këshilltar për vitin 2009?

-A keni një zonë të caktuar apo një target grup për të cilin mund të kontribuoni më shumë? etj...

Miratimi i buxhetit sikur i ndezi motorët disi të shuar të debatit. Për këshilltarët kjo pikë e rendit të ditës ishte e vlerësuar më shumë se pikat e para të rendit të mbledhjes së këshillit të bashkiak. Treguesit e buxhetit për vitin 2009 kanë rritje si në të ardhura dhe në shpenzime.

Në emër të komisionit të ekonomisë foli Todi Angjellari, i cili u shpreh se anëtarët e komisionit morën pjesë dhe analizuan punën që është bërë për hartimin e buxhetit të vitit 2009.

Në komision u ngrit si problem se a janë përfshirë transfertat, dhe u dha përgjigje nga ekspertë se nuk do të ketë mbartje. Sipas parashikimeve që kemi bërë në buxhet të miratuar më parë dhe në këtë buxhet, të gjitha

Ankesa nga qytetarët

Në fund të mbledhjes, pas diskutimit dhe miratimit të 10 të pikave të rendit të ditës, ishin qytetarët, të cilët prisnin t'u jepej fjala e të shprehnin problemet që ata kanë. Në këtë mbledhje pjesëmarrja e qytetarëve ishte më e madhe në krahasim me mbledhjen e kaluar. Qytetarët që merrnin pjesë në mbledhje, ishin banorë në "ish kampi i pionerëve" të cilët janë futur në këto banesa që nga vitet '90 dhe jetojnë aty prej rreth 17 vjet. Problemi që ata i shqetëson është fakti që ish pronarët e banesave u kanë kërkuar pronat e tyre dhe këta qytetarë ndjehen çdo ditë të kërcënuar nga ata.

Qytetarët ia transmetuan problemin e tyre kryetarit të bashkisë, me shpresën se do të gjejnë mbështetje prej tij. Kryetari u shpjegoi procedurën: bashkia nuk operon dot atje ku pronarët paraqitin dokumentat ligjore. E vetmja ndihmë që bashkia u ofron është që t'u akordojë këtyre qytetarëve të pastrehë një godinë për strehimin e tyre. Bashkia do të bëjë kërkesë për ndërtimin e 2 pallateve dhe ky projekt pritet të financohet së shpejti.

Gjatë diskutimit, midis qytetarëve dhe kryetarit u shkëmbyen replika të ashpra.

"Kur të dhamë votën na premtove shumë, tani na hodhe si qentë në rrugë, kjo s'është demokraci," shprehet një qytetare. Këto krijuan një atmosferë aspak të dëshirueshme. Pas largimit të tyre kryetari u shpreh se këta janë qytetarë që duan të përfitojnë nga bashkia sepse në të vërtetë ata kanë nga dy banesa.

Grupi monitorues



Buxheti vendor përfshin të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë vendore

Bashkia si njësi e qeverisjes vendore është e krijuar me ligj të veçantë dhe ka si veprimtari parësore përmeshjen e funksioneve të qeverisjes vendore brenda territorit të përcaktuar për të.

Buxheti dhe menaxhimi i tij në qeverisjen vendore

Ajo ka një buxhet për çdo vit, të cilin e krijon dhe e menaxhon në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e saj ndaj komunitetit.

Buxheti i qeverisjes vendore përfshihet në komponentët e rëndësishëm të buxhetit të përgjithshëm të shtetit.

Buxheti është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me vendim të këshillit të njësisë të qeverisjes vendore (këshillit bashkiak).

Ky buxhet bazohet në ligjin buxhetor vjetor, i cili miraton të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e buxhetit të shtetit, fondet speciale qendrore dhe transfertat nga buxheti i shtetit për njësitë e qeverisjes vendore, për vitin buxhetor.

Në çdo vit buxhetor përcaktohet një fond i miratuar, i cili është kufiri maksimal i miratuar me vendim të këshillit bashkiak, brenda të cilit njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të bëjnë shpenzime.

Buxheti vendor përfshin të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë vendore.

Ai përfshin një fond rezervë dhe një fond të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në vendimin e buxhetit vjetor deri në masën 3 përqind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondi special është ai i krijuar me ligj, që ka si burime të ardhura tatimore ose jotatimore, të cilat përdoren vetëm për financimin e funksioneve apo veprimtarive të veçanta të njësisë së qeverisjes vendore.

Ky fond paraqitet në mbledhjen e Këshillit bashkiak së bashku me fondin buxhetor vendor dhe i propozohet Ministrisë të Financave nga këshilli



Menaxhimi i buxhetit bazohet në disa parime, përkatësisht:

1. Transparenca, e cila siguron për këshillin bashkiak dhe publikun e gjerë të dhëna lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme
2. Parashikueshmëria dhe gjithëpërfshirja në menaxhimin e fondeve
3. Disiplina fiskale që lidhet me mbledhjen e taksave dhe tatimeve lokale
4. Shpërndarja dhe përdorimi ekonomik i të gjitha burimeve publike
5. Përgjegjësia në menaxhim dhe respektimi i procesit buxhetor

bashkiak.

Nuk mund të krijohet asnjë fond tjetër, nëse ai nuk është special.

Buxheti vendor është i balancuar, me përjashtim të shpenzimeve kapitale të financuara me hua.

Kryetari i bashkisë ka kompetencë të propozojë drejtimit kryesorë të politikës së njësisë të qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin në këshillin bashkiak.

Brenda muajit shkurt të çdo viti miratohet dhe dërgohet për zbatim në njësitë e qeverisjes vendore udhëzimi për përgatitjen e buxhetit.

Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore përgatitet nga nëpunësi i autorizuar (drejtori ekonomik dhe stafi përkatës) pasi janë organizuar më parë edhe takimet me komunitetin.

Ky nëpunës i Bashkisë në bashkëpunim me këshilltarët e grupit ekonomik, organizon mbledhjet për diskutimin e buxhetit, i cili më pas do të

paraqitet për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Brenda muajit nëntor të vitit buxhetor kryetari i Bashkisë paraqit për miratim

buxhetin tek Këshilli Bashkiak.

Ky këshill brenda datës 31 dhjetor miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Buxheti i qeverisjes vendore duhet të publikohet në Buletinin e Njoftimeve publike përkatës 15 ditë pas miratimit nga Këshilli bashkiak.

Në rast kur buxheti nuk miratohet nga Këshilli Bashkiak deri në ditën e parë të vitit buxhetor, kryetari i Bashkisë autorizon të kryhen çdo muaj shpenzime deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës, për të siguruar vazhdimin e ofritit të shërbimeve dhe zbatimin e projekteve apo investimeve të filluara, të cilat do të vazhdojnë.

Kryetari i Bashkisë bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe në rast se është e nevojshme, ka të drejtë t'i propozojë Këshillit bashkiak ndryshime në buxhet.

Botimi i këtij suplementi është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

Juriste
Kleda Shyta



Edhe unë jam PJESEMARRRES



Ligji 9920, datë 19.5.2008

“Mbi procedurat tatimore në RSH”

-Rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore dhe parimet e organizimit të administratës tatimore

Tatim: -pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara.

Taksë: -pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e qeverisjes vendore, e vendosur me ligj e që paguhet nga çdo person që përfiton një shërbim publik.

Vend kryesor i biznesit: -vendi i administrimit efektiv të biznesit

Detyrimi tatimor lind:

-Kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit sipas legjislacionit.

-Edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në formë të jashtëligjshme

Komunikimi me taksapaguesin:

-Informacioni tatimor ofrohet pa pagesë

-Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve

-Punonjësit ruajnë konfidencialitetin e të dhënave financiare e tatimore

Urdhër i bllokimit të llogarive bankare

-Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin në datën e caktuar, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhëri me shkrim, i kërkon çdo banke, ku ai ka llogari në emrin e vet, të mbajë një shumë, e cila duhet

-Zbatohet për sistemin e taksave e tarifave vendore, për atë që nuk rregullohen me ligjin 9632

të jetë më e vogël ndërmjet:

a) shumës që kërkohet të mbahet

b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit

(ky urdhër ekzekutohet i pari nga banka)

-Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin në datën e caktuar, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit.

a) Masa e sigurimit të detyrimit tatimor mund të jetë barrë siguroese ose barrë hipotekare. Vendimi për këtë bëhet me shkrim nga titullarët.

b) Para se të vendoset kjo masë njoftohet tatimpaguesi me shkrim

c) Brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni për këtë parregullsi, tatimpaguesi ka të drejtën e ankimit.

-Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin në datën e caktuar, administrata mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore.

-Urdhëri i sekuestrimit përmban:

a) Shumën e detyrimeve tatimore të papaguara

b) Afatin për pagesën e detyrimeve

c) Pasurinë që sekuestrohet

d) Mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit

e) Informacion rreth të drejtës së tatimpaguesit për ankimim

-Pasuria e sekuestruar shitet në

ankand publik

Ankimimi -bëhet me shkrim nga tatimpaguesi brenda 30 ditëve nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë nga tatimpaguesi.

Dënimet administrative:

-Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim, apo detyrimit për përditësimin e të dhënave dënohet me gjobë 25.000 lekë për çdo shkelje.

-Tatimpaguesi që nuk lëshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë 10.000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar.

-Tatimpaguesi, i cili nuk arrin të paguajë shumën e detyrimit tatimor, paguan një gjobë të barabartë me 5% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj apo pjesë të muajit, gjatë të cilit pagesa nuk është kryer. Shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë dhe më e madhe se 25% e detyrimit të papaguar.

-Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë, dënohet me gjobë të barabartë me 5% të shumës së detyrimit të papaguar apo rimbursimit të kërkuar më tepër. Shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë dhe më e madhe se 25% e detyrimit të papaguar.

-Fshehja e detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të dokumentave false, deklaratave të pavërteta, vlerësimi i të cilave çon në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion fiskal dhe dënohet me gjobë 100% të diferencës së shumës së

përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.

-Tatimpaguesi që nuk mban regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, detyrohet të paguajë gjobë 10.000 lekë për çdo shkelje, kur është biznes i vogël.

-Tatimpaguesit që kryejnë transaksione me para në dorë për shuma mbi 300.000 lekë, dënohen me gjobë në masën 10% të vlerës të secilit transaksion.

-Tatimpaguesi dënohet me gjobë nga 20.000 -100.000 lekë nëse:

a) nuk instalon e përdor pajisje fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë

b) nuk lëshon kupon tatimor

c) lëshon biletë që nuk ka elementet sipas ligjit

d) lëshon kupon me vlerë të ndryshme nga çmimi i afishuar

e) nuk afishon detyrimin e blerësit për kupon

f) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit

g) nuk mban libër llogarie për qarkullimin e mallrave

Refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore dënohet me gjobë 10.000 -50.000 lekë për çdo shkelje.

-Kur pengon ushtrimin e kontrollit, dënohet me gjobë 100.000 lekë për biznesin e vogël.

-Tatimpaguesi që lëshon faturë tatimore të pasaktë, dënohet me gjobë 50% të shumës të efektit të uljes së detyrimit tatimor.

-Kur fatura e pasaktë nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit, dënohet me gjobë 10.000 lekë.

-Mosafishimi i çmimit të shitjes dënohet me gjobë 35.000 lekë për biznesin e vogël.

Përgatiti: **Lindita Oshafi**

Kur qendra e Shqipërisë të sotme u zhvendos nga Shkodra në Tiranë ku u përqendrua agjencia e strategjia serbe!?

A e dinë kush është Branisllav Nushiqi

vijon nga faqja 1

Tani është pensionist këtu në Pogradec. I kërkova të ruante çdo gazetë që i binte në dorë nga Kosova dhe të ma jepte kur të kishte mundësi. Akoma ishte kohë e censurës dhe punë jo pa rrezik, por Fariu ishte burrë me karakter dhe po ta jepte fjalën, e mbante.

Kështu më solli disa gazeta dhe mes tyre "Zërin e Rinisë", numrin që kishte "Ekspozitën e tmerrit", të cilën e kam dhe sot dhe "Fjalën", e cila kishte në faqen e fundit të saj, me shkrim të imët shkrimin me titull "Kush është Branisllav Nushiqi".

"FJALA" e Kosovës ishte me sa mbaj mend gazetë e përdyjavshme dhe me format të madh. Nuk më kujtohet cili historian apo studiues i Kosovës e kishte gjurmuar e gjetur materialin. Në atë kohë të gjithë shkrimtarët, artistët e studiuesit e Kosovës ishin në një front për çështjen kombëtare dhe Kosovën Republikë si hap drejt pavarësisë, përjashtojë të shiturit dhe të dorëzuarit apo të natyralizuarit me pushtimin si kudo në raste të tilla.

Nuk ishte analizë, ishte botimi i letrës së Branisllav Nushiqi dërguar Mbretit të Serbisë dhe Ministrit të PJ të Mbretërisë Serbe si përfaqësues i Mbretërisë Serbe pranë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nga përmbajtja e saj dilte në dritë të diellit kush ishte ky Branisllav Nushiqi: hartuesi i një platforme antishqiptare, e cila që prej atëherë ka qenë më djallëzoria.

Në fillim jepeshin nga autori shkurt të dhëna për B.Nushiqi, me origjinë nga babai nga fshatrat e bregut të Vlorës, i cili kishte emigruar në të ri në Serbi a Mal të Zi, ishte martuar me një serbe, kishin pjellë një djalë që i vunë emrin Brano Nushi, i cili si u rrit, kishte mbaruar shkollën në Beograd dhe për të theksuar se ishte serb i vërtetë dhe jo gjysmak, e kishte përpunuar emrin nga Brano në Branisllav dhe mbiemrin nga Nushi në Nushiqi. Më tej caktohet nga Mbreti i Serbisë si përfaqësues i tij pranë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pas kësaj vazhdon letra e Branisllavit me informacionet e rekomandimet për Mbretin e Serbisë dhe qeverinë serbe për shkatërrimin e Lidhjes së Prizrenit, ndërtimin e një platforme



antishqiptare, kanalizimin e tyre në interes të Serbisë dhe thelbi i përmbajtjes ishte ky:

LSH Prizrenit ka organizuar 70000 luftëtarë të armatosur nga të gjithë viset e Shqipërisë të vendosur deri në vdekje për çështjen e tyre.

Kësaj hordhie të armatosur (citohet Branisllav Nushiqi) nuk do t'i bënte ballë asnjë fuqi ballkanike veç Portës së Lartë.

Mbretëria e Serbisë nuk duhet të përplasat me këtë fuqi ushtarake. Ajo duhet të bëjë sikur e mbështet, ndërsa do të gjejë kohë të mjaftueshme për ta drejtuar kundër Portës së Lartë. Kjo është e vetmja mënyrë për ta mposhtur. Kështu Serbia do të zgjidhë të gjithë pretendimet e saj në Kosovë dhe viset shqiptare.

Njëkohësisht, -vazhdon Nushiqi në letrën e tij, -duhet t'i japim të kuptojë Stambollit që nuk po veprohet kundër Portës. Ndaj në mbështetje të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit do të dalë ndonjë shoqatë a lëvizje serbe që do t'i bëjë shqiptarët të kuptojnë se Serbia është me ta, ndërsa qeveria serbe do të reagojë kundër saj duke u thënë shqiptarëve se s'kemi ç't'i bëjmë hapur Portës së Lartë e kësaj të fundit do t'i lëmë të kuptojë se këto lëvizje nuk janë politike shtetërore.

Gjithashtu, -vazhdon Nushiqi, -duhet bindur Mbretëria e Malit të Zi që të lejojë një konsull serb në Shkodër se Lidhja Shqiptare e Prizrenit këmbët i ka në Prizren ndërsa kokën e ka në Shkodër.

Ky ishte thelbi i letrës së Nushiqi dhe ngjau si ai e planifikoi. Në LSH të Prizrenit fitoi krahu që kërkonte luftë me Portën e Lartë dhe dihen pasojat.

Bashkë me shkatërrimin e LSHP mori goditje të pariparueshme për më shumë se 100 vjet dhe çështja shqiptare në tërësi. Serbia aneksoi Kosovën dhe Shqipërinë Juglindore, Mali i Zi Veriun e Shqipërisë dhe Greqia Jugun e saj, Çamërinë, e cila përveçse u zaptua, u çpopullua me masakra e gjenocid të paparë në historinë e Europës.

Gjakderdhja e 10 viteve të fundit të shekullit të njëzetë në Ballkan nuk i ka rrënjët në sundimin otoman, por në copëtimin e trojeve shqiptare gjatë përmbyesjes së Portës së Lartë, në zaptimet dhe gjenocidin mbi popullatën autoktone shqiptare. Që në momentin e krijimit të shtetit grek e serb, nisi politika e aneksimit të teritoreve shqiptare, asimilimit të popullatës së tyre dhe kur kjo nuk arrihej, fillonin shfarosjet dhe çpopullimin e tyre, pra vise të Shqipërisë pa shqiptarë. Këtu i kanë rrënjët politikat e egra të gjenocidit në Ballkan, këto janë rrënjët në krijimin dhe zgjerimin e shteteve të Serbisë e Greqisë, këtu fillojnë politikat çnjerëzore e plaçkitëse të këtyre krijesave të ushqyera me masakra mbi trojet e popullatën shqiptare.

Dhe sot e kësaj dite nuk kanë hequr dorë nga politika aneksioniste mesjetare, veçse kanë përshtatur taktikat në kushtet e krijuara kundër dëshirës së tyre dhe me forcë. Sot ata kanë zaptuar dhe po zaptojnë ekonominë strategjike të Shqipërisë, një farë kolonializmi modern, njëfarë pushtimi i butë duke sunduar pasuritë, burimet, ekonominë bankat dhe duke shfrytëzuar fuqinë e saj punëtore, nën emër të "lirisë të tregut". Kjo është

platforma e tyre sot dhe kjo duket sheshit. Prej mëse 18 vjet firma greke e serbe, hapur apo të mbuluara si amerikane a britanike a europiane, ia dalin të eliminojnë në bashkëpunim me burokracinë e korruptuar, në fusha strategjike, me tendera, pa tendera firma e sipërmarrje nga më të njohurat në Europë dhe nga vende miq e dashamirë, ose nga vende jo dashakeqë ndaj interesave strategjike e natyrale të shqiptarëve në Ballkan.

Ndaj shtrohet pyetja: Kur qendra e Shqipërisë të sotme u zhvendos nga Shkodra në Tiranë ku u përqendrua agjencia e strategjia serbe!? Sigurisht në Tiranë. Historia e midis dy luftimeve, e Luftës së Dytë dhe e pas Luftës së Dytë botërore e vërtetoi këtë, me kontributin e dhënë për krijimin e PKSH nën tutelën e PKJ, në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, i cili ishte kundër interesave të shqiptarëve dhe pro interesave të Serbisë e Greqisë, kishte apo s'kishte luftë ideologjike midis tyre.

Nëse Shqipëria e sotme do të ishte demokraci, pra jo diktaturë, pas Luftës së Dytë Botërore, Serbia do të gjendej rrugës si Rusia para Gjermanisë Perëndimore dhe me shqiptarët nuk do të luhej njësoj sikundër nuk luhet dot sot njësoj. Shqipëria do të ishte "Zvicra e Ballkanit" siç ishte ëndërruar prej shekujsh dhe Kosova në minimum do të ishte "Sllovenia" në jugun e Jugosllavisë e Serbisë. Nushiqi, Çubrilloviqi e Millosheviqi e dinin këtë, i kishin bërë mirë llogaritë deri ditën kur luftëtarët e lirisë morën armët në dorë për çlirimin e Kosovës dhe kështu dhe të Shqipërisë, deri ditën kur Presidenti Clinton lexoi 600 faqe histori, pra thelbin e saj, atë që marrim me mend nga pasojat historike (sipas Xh.Rubin, zëdhënës i Shtëpisë të Bardhë që njoftoi ndërhyrjen ushtarake të NATO-s), deri kur Kryeministri i Britanisë Toni Bler vraponte nëpër shkallët e avionit për të takuar refugjatët kosovarë e deri kur Franca u kthye më në fund në krahun e të drejtës dhe fatkeqësia e fatmirësia njëkohësisht i ribashkoi shqiptarët pas mëse një shekulli.

Dua të falënderoj atë studiues kosovar, dijetar me kurajo e me vijon në faqen 14

vijon nga faqja 13

mendje të mprehtë që botoi para 20 vjetëve këtë material historik, që zbardh politikën e Serbisë dhe për analogji dhe të Greqisë.

Nëse në Kosovë e dinë mirë kush është Branislav Nushiqi, Çubrilloviqi dhe Akademia Serbe, në Shqipëri s'është e njëjta gjë. Platforma antishqiptare punonte nëpërmjet nomenklaturës, propagandës, falsifikimit të fakteve historike dhe politika antishqiptare kishte penetruar thellë e lart.

Platforma "Nushiqi", si dosja "Mitrokin" që do të thotë të bësh agentin pa e ditur që je i tillë, u përshtat në këtë rast si penetrim politik, ideologjik e moral e si platformë e eliminimit të ideve nacionaliste dhe mbartësve të tyre dhe si agjunkturë e drejtpërdrejtë apo vasalitet i fshehur nga faqja e publikut. Ndaj ka vlera ribotimi i këtij shkrimi, i cili duhet të jetë gjekundi në ndonjë shtëpi a bibliotekë shqiptare. Duhet ta dinë dhe shqiptarët e këtushëm kush është Branislav Nushiqi dhe platforma e tij e stërholluar antishqiptare, kush është ky gjysmëserb gjysmëshqiptar nga gjaku e më serb se serbët nga mendja e veprat. Kështu do të dinë të dallojnë ata që kanë qenë e janë me mendjen e tij, ata që janë të infektuar prej saj dhe ata që padashje i kanë shërbyer asaj. Në kohën e diktaturës në dukje bëhej përpjekje të krijohet ideja se mbështetej Kosova dhe çështja shqiptare, por kjo çështje përdorej për interesa të klikës në pushtet për faqe të publikut dhe sidomos për të patur influencë në opinionin e shqiptarëve në emigrim dhe në fakt bëhej e kundërta. Sigurimi i Shtetit praktikisht bashkëpunonte me UDB, patjetër me marrëveshje midis dy palëve. Shqiptarët e arratisur në Jugosllavi ktheheshin në Shqipëri dhe kosovarët e ardhur në Shqipëri ilegalisht përgjithësisht dorëzoheshin në Jugosllavi ose burgoseshin si agentë. Duhet të ketë qindra raste të tilla të dokumentuara.

Me "politikën e shkallëzimit" u krijua gradualisht psikoza se çdo kosovar është "agjent i UDB" dhe kjo do të përshtatej me të njëjtën politikë pas rënies së diktaturës, me përhapjen e psikozës se kosovarët janë "të ligj e të pabesë etj" me forma të hapura dhe me gazetën gojore agjunkturë. Politikë e shkallëzimit ishte përpunimi gradual i opinionit me qëllim të caktuar me të gjitha mjetet e e propagandës. Në kohën e diktaturës funksiononte nëpërmjet strukturave të caktuara, të cilat më pas nuk u nxorën në faqe të diellit asnjëherë. Fillonin

A e dinë kush është Branislav Nushiqi

punën nëpërmjet gazetës gojore, e më pas e merrte në dorë partia e organet e diktaturës sipas rasti, ose më së paku krijohet një opinion në shërbim të regjimit. Këto psikoza u shembën kur Kosova u çlirua dhe me këtë rast ndërrohet krahun dhe përpunuesit e opinionit në këtë drejtim. Tani ata kanë front të ri, mund t'i shohësh dhe të bërtasin për Kosovën e çështjen kombëtare dhe më në fund dhe kjo është një tregues i madh, nuk u ka mbetur udhë tjetër. Kur plasën demonstratat e studentëve në Prishtinë në vitin 1981, me gazetën gojore u hap fjala se një kryeartikull në ZP që bënte thirrje për largimin e tankeve e ushtrisë nga protestat studentore, ishte shkruar nga E.Hoxha. Ia thashë këtë xhaxhait tim Qani Çollaku. Në atë kohë kishte disa vjet që kishte vuajtur dënimin politik për "agjitacion e propagandë" neni 55 i Kodit Penal. U dënua se kërkoi publikisht liri fjale e demokraci për popullin e vet, ishte kundër trekëndëshit "Mësim, punë, kalitje" dhe si mësues i vërtetë që ishte u mësonte fëmijëve shkencë e art e jo ideologji, u dënua se e dinte e ishte i bindur që vëllezërit e tij dhanë jetën për lirinë e pupullit e jo skllavërimin e tij. Ishte i biri i Isuf Çollakut dhe vëllai i Reshit Çollakut -Hero i Popullit dhe Muharrem Çollakut -Dëshmor i Atdheut. Mbas vdekjes, kur diktatura ishte shembur me Dekret të Presidentit Berisha u nderua me titullin "Mësues i Popullit" dhe i tillë ishte vërtet.

Qani Çollaku u përgjigj:

"Nuk kanë vlerë fjalët kur populli shqiptar i Kosovës masakrohet. Shqipëria duhet të reagojë si shtet e si popull. Ai duhet të vendosë ushtrinë e tanket në kufi e t'i thotë Serbisë -Hiqi tanket nga Kosova, ndryshe do të përballesh me të gjithë shqiptarët."

Ndërkohë pas rënies së diktaturës punohej në të dy krahët për të përhapur psikologjinë e kapitullimit para makinerisë ushtarake serbe, me krijimin e psikozës se është e pamundur të luftohej kundër saj, se ajo do të nënshtronte çdo ushtri në Ballkan e për më tepër s'e kish për gjë e Italinë. Këto psikoza përhapeshin jo rastësisht dhe i kam gjetur dhe midis disa shqiptarëve të Kosovës në Zyrih në fund të nëntorit 1998, të cilët e shtronin me emocion e

përkushtim çështjen e Kosovës, por u ish mbushur mendja se nuk i dilej kësaj makinerie.

Kjo psikoze u thye nga mësimi më i vjetër i historisë se lufta për liri nuk merr parasysh fuqinë dhe egërsinë e pushtuesit, e ajo ditë do të vinte si dhe erdhi. Ata që luftuan me penën, mendjen e tyre dhe me gjithçka, mundën këtë psikoze e u ndeshën me të, ishin në krahun e duhur në shërbim të Atdheut të tyre e çështjes kombëtare, mbajtën ndezur shkëndijën e lirisë që prej ditës së robërisë të Kosovës e deri në çlirimin e saj, për më tepër se katër breza. Ata që rrëmbyen armët dhe thyen me çdo sakrificë të mundshme njerëzore këtë psikoze, ata fituan betejën e parë për pavarësinë e Kosovës, në frontin më të vështirë. Ata të cilët u flijuan, apo u mbijetuan betejave, luftuan për lirinë e gjithë shqiptarëve dhe brezave që do të vijin, ata thyen prangat e nënshtrimit e gjuhëzimit para pushtuesit dhe sollën ditën e nderuar të shqiptarëve e të lirisë, pavarësinë e Kosovës.

Pavarësia e Kosovës dhe komunikimi mbarëshqiptar ka goditur dhe shkukur rrënjët e psikologjinë antishqiptare në vetë gojën e shqiptarëve, por nuk i ka zhdukur ato, përderisa nuk u është dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

Cila ka qenë agjuntura serbe e greke në Shqipëri nga koha e LSHP e këtej e ç'detyra ka kryer? Si ajo ka kanalizuar politikën shqiptare pro interesit të saj e kundër interesave të vendit e çështjes shqiptare? Cila është politika e vërtetë e shtetit grek e serb që në ditën e krijimit të tyre, në raport me çështjen shqiptare? Cilat rryma politike ideologjike, morale, forca politike apo individë, janë financiar e mbështetur drejtpërdrejt apo indirekt nga këto politika? Cila është platforma e tyre në kushtet e sotme? Pse gjithë krerët e shtetit grek deri në çlirimin e Kosovës kanë deklaruar hapur se "Kosova nën Serbi është interes strategjik i Greqisë? Pse sot mbahet peng Kosova me veriun e Mitrovicës nga Rusia e Serbia dhe shtypet pa mëshirë

popullsia shqiptare në Preshevë, Bujanovc e Medvegje?

Pa këto përgjigje historia e Shqipërisë, Kosovës dhe çështjes shqiptare në Ballkan do të jetë e paplotë, ose me gjysmë të helmuar si Nushiqi. Pa këto përgjigje nuk mund të shkruhet si është historia e Ballkanit dhe kështu dhe e Europës, e cila më në fund hoqi dorë nga mbështetja e politikës aneksoniste e koloniale të Serbisë e Greqisë në Ballkan dhe nga heshtja për gjenocidin ndaj popullit shqiptar. Çështja shqiptare do të vihet në vend dhe historia duhet të nxjerrë në dritë të vërtetat e nuk duhet të lërë në harresë masakrat shekullore të serbëve e grekëve ndaj shqiptarëve autoktonë. Politika sllave doli në dritë me gjithë takimet e saj në fund të viteve 90. Pas ushtrisë serbe, doli hapur ta shohin dhe ata që s'kanë sy e mendje, politika antishqiptare shekullore e pansllaviste e Rosisë, për të cilën Sekretari Amerikan për Mbrojtjen në Prishtinë deklaroi se "Nuk do të lejohet më që Rusia ta përdorë Kosovën si oborrin e saj mbrapa shtëpisë." Tani Putini flet si dikur Cari i Rosisë e Mbreti i Serbisë diku nga shekulli i 19 dhe nushiqët e tij janë koshtuniqët e tadiqët.

Kjo rrëzoi më në fund dhe tezën e disa internacionalistëve shqiptarë (që ka dhe sot), se Rusia nuk do t'ia dijë për Kosovën dhe çështjen shqiptare. Nga deklaratat e Putinit duket sheshit se me çfarë fuqish madhore djallëzore e dashakeqe ka patur të bëjë çështja shqiptare, atdhetarët shqiptarë e luftëtarët e lirisë, për më tepër se një shekull e gjysëm, sa e vështirë ka qenë fitorja e pavarësisë të Kosovës dhe për këtë shkak dhe pse e vonuar, sa e ndritur, sa e bardhë, sa ditëmirë!

Çështja shqiptare me pavarësinë e Kosovës ka marrë zgjidhjen e saj thelbësore, por akoma është një trung, jo i krasitur, por i prerë deri në degë, që pret të lulëzojë. Do të zgjidhet përfundimisht kur shqiptarët të vendosin të lirë të bashkohen në trojet e tyre etnike e natyrale, kur politika shqiptare nuk do t'u lëshojë pe për interesa kolltuqesh politikave neokolonialiste të Greqisë e Serbisë, kur interesat jetike e strategjike të shqiptarëve do të mbrohen me kurajo nga vetë ata dhe përfaqësuesit e tyre politikë, kur Greqia do t'i kthejë tokat e grabitura me dhunë e gjenocid popullit shqiptar të Çamërisë.

Pogradec më 03.01.2009

Besnik Çollaku

Shënim: Titulli është i njëjtë si tek "Fjala" e Kosovës para 20 vjetëve në respekt e nderim të atij që e ka nxjerrë në dritë dhe të asaj redaksie që e ka botuar dhe si thirrje për rigjetjen dhe ribotimin e këtij materiali ashtu si është botuar në atë kohë".

Horoskopi javor i "Nositit"



Dashi (21.3-20.4)

Do të ndiqni ritmin e zakonshëm duke vepruar me korrektësi për çdo problem që ju del.



Peshorja (24.9-22.10)

Mund të mos arrini të kaloni në krizë totale nga disa mosmarrëveshje mes jush e të tjerëve.



Demi (21.4-20.5)

Duke përdorur fraza të kamufluara do të përpiqeni t'u thoni të tjerëve atë që dëshirojnë.



Akrepi (23.10-22.11)

Mund të bëheni të padurueshëm për ata që ju rrethojnë me sjelljen tuaj aspak me takt.



Binjakët (21.5-21.6)

Do të përdorni një mjedis të sigurtë ku të mund të shprehni lirshëm mendimet tuaja.



Shigjetari (23.11-22.12)

Do të ndodheni para situatave të rrezikshme, prandaj duhet të jeni sa më të kujdesshëm.



Gaforrja (22.6-22.7)

Energjitë tuaja do të shtohen më tej duke mënjanuar bindshëm ata që s'ecin me hapin tuaj.



Bricjapi (23.12-20.1)

Një person që ju qëndron pranë do t'ju vërtetojë se miqësia mund të kthehet në armiqësi.



Luani (23.7-23.8)

Do të pësoni ndryshime drastike që nuk do t'ju pëlqejnë. Mos u tregoni arrogant në bisedë.



Ujori (21.1-19.2)

Ju duhet të bëni shumë kujdes për shëndetin, sepse diçka e vogël mund t'ju çojë në krizë.



Virgjëresha (24.8-23.9)

Do të mundoheni të neutralizoni një debat të ashpër midis dy personave që s'kanë të bëjnë me ju.



Peshqit (20.2-20.03)

Mund të futni hundët atje ku nuk duhet duke bezdisur të tjerët. Kujdes nga kurioziteti i tepërt.



SMS humoristike

Truri është një organ i mrekullueshëm. Fillon të punojë që nga momenti që zgjohesh nga gjumi dhe vazhdon gjersa vete në mëngjes në zyrë.

Kam filluar të pi për të të harruar, por është e kotë sepse më pas imazhi yt u dyfishua.

Jam shumë e sigurt që Zoti nuk është një femër. Asnjë femër nuk do të kishte bërë meshkuj kaq të trashë.

Shikoj diellin dhe të shikoj ty, shikoj hënën dhe të shikoj ty, shikoj qiellin dhe të shikoj ty... Dreqi e mori, do të më hiqesh nga sytë?

Kush gjen një mik, gjen një thesar, por kush gjen një thesar, nuk qan më për mikun.

Jo gjithmonë plehrat që janë rrugës i shkelim me këmbë, ndonjëherë edhe i përshëndesim.

Ti bën pjesë në gjërat që më kanë ndodhur sot dhe janë të gjitha të shpifura.


E di se sa i rëndësishëm jam për ty, e di se sa shumë e ndjen mungesën time, e di që ke shumë nevojë për mua, më vjen shumë keq që të kam braktisur. Me dashuri, truri yt.



Vipat Top Sekret

Hilton, s'kam histori me Clooney

Tani është single dhe e lumtur. Ne këtë fillimviti për 2009-ën



Hilton që vitin e kaluar u la nga i dashuri i saj, i është afruar divit hollivudian, George Clooney. Trashëgimtarja me e përfolur e planetit, ka dashur t'u japë fund thashethemeve. Paris ka thënë menjëherë se kishte dalë me divin, por në praninë e miqve të tjerë

dhe jo vetëm, pasi është akoma keq nga historia e fundit me pjesëtarin e grupit Good Charlotte. "Ishte miku im më i mirë, një prej personave më të dashur që unë kam takuar ndonjëherë. Me të kam qenë me të vërtetë e lumtur", tha Hilton. Përsa i përket Clooney, është një burrë i jashtëzakonshëm me të cilin flet, por asgjë më shumë. Fanset e George janë të gjitha të kënaqura, meqë idhulli i tyre është akoma në treg.

Mega party për 35-vjetorin e topmodeles Kate Moss

Vitin e kaluar ajo kishte premtuar se do të festonte 34-vjetorin e



saj me një festë maratonë prej 34 orësh, por të ftuarit dhe vetë ajo u dorëzuan pas 18 orëve. Kjo nuk i ka mjaftuar fotomodeles. Kësaj here ajo ka premtuar 4 ditë feste. Në darkë, në vilën e saj luksoze londineze, top modelja ishte veshur në stilin mesjetar.

"Kate ka shpenzuar me mijëra stërlina për të organizuar festën", ka thënë

një burim për një revistë angleze "nuk ka dashur t'i bërë gjërat përgjysëm dhe ka shpenzuar shumë më tepër se një vit më parë".

1		2	3	4		5		6		7	8	9		10
		11				12	13			14				
15	16		17		18				19				20	
21		22		23		24		25					26	
27			28		29		30				31			
		32		33		34					35			
36	37		38		39				40				41	
	42			43			44					45		
46			47				48		49		50			51
		52				53		54		55		56		
57	58				59				60		61		62	
63				64			65		66		67			
68			69				70		71		72		73	
		74				75		76		77		78		
79								80						



1-31 janar 2009

Ulje çmimi për **kancelaritë**



Ofertë fantastike për të pasuruar bibliotekat tuaja:

Dhuro **1** një libër në këtë fundvit!

Ne nuk shesim libra, Ofrojmë kulture.



Enti botues
D.I.J.A. - Poradeci
Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
dukailir@yahoo.com

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 454)

Horizontalisht: 1.Libia 5.Margarita 12.Ane 13.Al 14.Haga 16.Katalizatorë 19.Al 20.Elika 21.Min 22.Mira 23.Magneti 25.Edi 27.AP 28.SS 30.Po 31.Agasi 32.Tiren 34.Do 35.GG 36.Elin 37.Po 38.Loro 40.Tomas 41.Pandi 43.Aleko 45.TR 46.Rendi 48.Ue 49.Miz 50.Artiste 52.Isak 55.Visi 56.RN 57.Stan 58.Zia 59.Marika

Vertikalisht: 1.Laze 2.In 3.Bekim 4.Antagoniste 5.Maltezë 6.Ali 7.Gram 8.Rio Negro 9.Themistokli 10.Aa 11.Galapagos 15.Gora 17.Akapela 18.Ti 24.Indonezia 26.DA 28.Statuti 29.Si 33.Remo 37.Parisi 38.Lida 39.Ra 42.Dd 44.Katra 47.Irma 48.Uka 49.Miz 51.EN 53.SS 54.AT

Horizontalisht: 1.Ka kryeqytet Mogadisho 6.Janë banorët e Bombeit 11. ...Boletini 12. ...Biao 14.Medalja e të parit 15.Inicialet e këngëtares Bektashi 17.Instituti i Kulturës Fizike 19.Këngëtarja Qazimi 20.Inicialet e Jashinit 21. ...Noli 23.Mat kohën 25.Mund të jetë edhe me harqe 26.Tre në kapitull 27.Këngëtari italian Ramazoti 29.Vërtitet në vapor 31.Një mjet i thjeshtë transporti 32.Bashkë 34.Këngëtarja greke Visi 35.E bukura e Butrintit 36.Aktori Paçino 38.Kanuni i ...Dukagjinit 40.Peshk deti 41.Emër kinezi 42.Elbasani në targa 43.Quhet djali i djalit 44.Pluhur 45.Simboli kimik i hekurit 46.Bashkimi Sovjetik 47.Ho Shi... 49.Pjesa pa zë 52.E bukura e Butrintit 53.Jo kundër 55.Organizatë separatiste baske 57.Një... s' duhet t'ju shpëtojë nga dora 59.Aktorja Kurti 61.Kryeqyteti i Norvegjisë 63.Me... shoqërohen këngët labe 64.Këtë ditë 65.Tokë e mbjellë 67. ...Uno, kanal televiziv italian (në invers) 68.Po në Romë 69.Vihet ... për barazim në skedinë 71.Instituti Bujqësor Tiranë 73.Burreli në targa 74.Patrioti Kuka 75.Zihet... nga armiku 77.Si nr.55 79.Futbollisti Kola 80.Kryeqyteti i Gjermanisë

Vertikalisht: 1.Garë atletike me shkopinjë 2.Notë muzikore 3.Letër bixhozi 4.Natasha..., shkrimtare 5.Emri i Kapones 6.Inicialet e fizikanit Njuton 7. "... Pik" balet i Çajkovskit 8.Ushtria e Gerri Adams 9.Përemër vektor 10.Ka kryeqytet Kajro 13. ...Montan 16. ...bufe 18.I vuri... gojës 19.Lëvizja e ajrit 20.Sëmundje 22.Mësohet në ujë 24.Akoma 25.Shaban... ka qenë volejbollist dinamovit 26.Si nr.9 28.Notë muzikore 30.Një... dhjamor 31. ...Hasiao Pin 33.Ka kryeqytet Nairobi 35.Në... mbahen shkresat 37.Ish presidenti polak Valesa 39.Shkrimtari Dushi 40."Njeriu me..." roman i D.Agollit 41.Kanuni i ... Dukagjinit 46.Sali... ish president 47.Humoristi Bega 48.Acidi ribonukleik shkurt 50.Njëqind për rusët 51. ...i natriumit, kripë e acidit klorhidrik 52.Patrioti Kuka 53.Tenisti Sampras 54.Degë e lumit Vollga 56.Letër bixhozi 58.Si nr.56 59.Pluhuri 60.Medalja e të parit 62.Quhet banori i Kurveleshit 64.Valter... romancier anglez 66.Lajmi, ndryshe 69.Instituti i Studimeve Sizmike 70.Lumë në Itali 72.Total pa zë 74.Obuz 76.Inicialet e trajnerit Birçe 78.Përemër vektor

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
redaksianositi@yahoo.com